



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM  
Nr. 302, datë 23.12.2020

**PËR NDALIMIN E KANDIDIMIT TË KANDIDATIT MARSIDA FRASHËRI PËR  
NGRITJEN NË DETYRË NË POZICIONIN E DREJTUESIT TË PROKURORISË  
PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË SHKODËR**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 47 pika 6, nenin 52 pika 9, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në pikën 3 të nenit 5 dhe në nenin 9 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm” miratuar me Vendimin nr. 200, datë 23.09.2020 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**V E N D O S I:**

1. Ndalimin e kandidimit për kandidatin Znj. Marsida Frashëri për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.
2. Vendimit i bashkëngjitet relacioni shpjegues i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.
3. Të njoftojë Znj. Marsida Frashëri për këtë Vendim.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga dita e njoftimit të Vendimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**KRYETARI  
GETN IBRAHIMI**

**ZV/KRYETARI  
ALFRED BALLA**

**ANËTAR  
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR  
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR  
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR  
SANDËR BECI**

**ANËTAR  
VATË STAKAJ**

**ANËTAR  
TARTAR BAZAJ**

**ANËTAR  
ESMERALDA KESHI**